# Raport i permbledhur per zbatimin e ligjit per konsultimin publik 2017-2018




Me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED), në kuadër të projektit *"Promovimi i pjesmarrjes qytetare në advokimin legjislativ"*, Res Publica po vijon monitorimin e zbatimit te ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Për periudhën e deritanishme, 2017 – 2018, po publikojmë një raport të permbledhur, në të cilin analizohen të dhënat që janë mbledhur deri në këtë periudhë dhe disa nga indikatorët mbi të cilat do të mbështetet dhe përgatitja e studimit përfundimtar në Mars 2019. [Për më shumë klikoni këtu për të shkarkuar raportin].

Situata deri tani shfaqet problematike. Organet publike janë ende larg zbatimit në mënyrë efektive të ligjit dhe akteve nënligjore. Në vija të përgjithshme konstatohet që Ministritë nuk i plotësojnë tabelat për njoftimin dhe konsultimin publik të projektakteve. Ministritë nuk hartojnë dhe nuk publikojnë raportet vjetore të transparencës. Konstatohet që Bashkitë kanë mungesë informacioni dhe nuk kuptojnë kush janë aktet që përfshihen dhe janë subjekt i ligjit për njoftimin dhe

konsultimin publik, duke demonstruar nevojë urgjente për trajnime në këtë fushë. Regjistri për Njoftimin dhe Konsultimin Publik është ende shumë larg funksionimit në mënyrë efektive, sepse nga njëra ana institucionet pothuaj nuk e përdorin këtë faqe dhe nga ana tjetër publiku nuk shfaq asnjë interes për këtë faqe.

Nga ana tjetër, cilësia e komenteve dhe rekomandimeve të ardhura nga publiku lë ende për të dëshiruar dhe pjesa më e madhe e grupeve të interesit nuk shfaqin rol aktiv në proceset vendimmarrëse edhe kur u jepet mundësia të marrin pjesë në to.

Të dhënat dhe gjetjet që do të rezultojnë në fund të këtij projekti, do të krahasohen me të dhënat e studimeve paraprake, me qëllim konstatimin se si organet publike zbatojnë detyrimet që rrjedhin nga ligji dhe sa efektiv është ky ligj në duart e qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile, grupeve të interesit. Rekomandimet që do të dalin nga ky studim, do t'i vendosen në dispozicion institucioneve kompetente dhe aktorëve të fushës me qëllim marrjen e masave administrative si dhe për të bërë amendimet e nevojshme në ligj.

Res Publica

---

# Commentary of law no. 146/2014 "On notification and public consultation"

An important piece of legislation adopted in 2014 following intensive lobbying by civil society was Law no. 146/2014 "On Notification and Public Consultation". The law seeks to ensure that citizens have a say in decision making processes and

provides for a complex procedure whereby the competent state authorities should, during the phase of drafting laws, policies and strategies, also hold consultations with the public with a view to soliciting its feedback.

In light of the novel character of the law and in order to make the law more accessible to the public in general and civil society in particular, Res Publica, with the support of the National Endowment for Democracy, has prepared a commentary in which key aspects of the new law are set out in non-technical language.

The commentary is available in English by clicking here.

---

# Komentar i ligjit nr. 146/2014 "Per njoftimin dhe konsultimin publik"

Nje nga risite ne legjislacionin e propozuar nga shoqeria civile ne vitin 2014 ishte edhe ligji nr. 146/2014 "Per njoftimin dhe konsultimin publik". Ligji synon te perfshije qytetaret ne vendimmarrje duke marre prej tyre rekomandime permes nje procesi kompleks ku autoritetet shteterore qe draftojne ligje, politika e strategji, duhet se pari te konsultohen me publikun.

Meqenese ky ligj eshte nje mjet i ri ne duart e publikut ne pergjithesi dhe shoqerise civile ne vecanti, Res Publica, me mbeshtetjen e National Endowment for Democracy, eshte perpjekur ta beje sa me te kuptueshem ligjin permes nje

komentari, ne menyre qe ai te perdoret sa me gjeresisht per rezultate sa me efektive.

Per me shume klikoni ketu per te shkarkuar komentarin. Lexim te kendshem.

Res Publica

---

# Konsultimi publik – Sfidat e vitit te pare te zbatimit te ligjit

Ne kuader te nje projekti te mbeshtetur nga National Endowment for Democracy, Res Publica ka ndermarre nje studim per efektivitetin e ligjit nr. 146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik”. Studimi u krye permes nje monitorimi te aurotiteteve shteterore kryesore qe marrin nisma legjislative.

Ne fokus u vu edhe vete ligji ne menyren se si eshte ndertuar, duke bere nje analize krahasuese me standardet nderkombetare ne kete fushe. Gjate periudhes se monitorimit Res Publica kreu edhe disa testime qe vune ne dukje probleme ne ligj, te tilla qe duhen te adresohen nga legjislatori. Ne perfundim te materialit jepen edhe rekomandimet perkatese. Per me shume klikoni ne kete link.

---

# Prezantim për ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

Së bashku me ligjin nr. 119/2014″Per te drejten e informimit”, pjese e paketes qe u miratua ishte edhe ligji nr. 146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik”. Res Publica ka pergatitur nje prezantim per te kuptuar konceptet baze te ligjit. Kliko këtu për të shkarkuar prezantimin.